



UET  
Nr. 226/3 Prot.  
Dt. 01.03.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

1406/1 Prot.

Tiranë, më 28.02.2017

URDHËR

Nr. 90, datë 28.02.2017

PËR

**MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Statutit të Universitetit European të Tiranës, propozuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 08, datë 03.11. 2016, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (33 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Universitetit European të Tiranës, të miratohen në zbatim të Statutit të Universitetit European të Tiranës dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Universiteti European i Tiranës brenda vitit akademik 2017-2018 të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
4. Ndryshimet në statutin e Universitetit European të Tiranës, miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
5. Statuti i Universitetit European të Tiranës, miratuar me shkresën e MASH Nr.9/1 Prot, datë 28.01.2013, i ndryshuar, shfuqizohet.
6. Statuti i Universitetit European të Tiranës, hyn në fuqi, pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti European i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: www.arsimi.gov.al



**MIRATOI**

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTEVE**

**LINDITA NIKOLLA**

## **STATUTI I UNIVERSITETIT EUROPIAN I TIRANËS**

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

1.1 Universiteti European i Tiranës, i quajtur këtu e në vazhdim UET, e ushtron aktivitetin bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

UET është krijuar me Vendimin Nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave "Për dhëni e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës" si dhe të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë".

UET është akredituar si institucion i arsimit të lartë, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009.

Programet e Studimit të Ciklit të Dytë janë hapur bazuar në VKM Nr. 255, datë 27.2.2008 dhe VKM 74, datë 21.1.2009 "Për hapjen e programeve të Ciklit të Dytë".

Programet e Studimit të Ciklit të Tretë, studime të doktoratës në "Shkenca Ekonomike", "Shkenca Sociale" dhe "Shkenca Juridike" janë hapur bazuar në Urdhrin Nr.503, datë 07.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 657, datë 28.09.2011, emërtimi i institucionit është ndryshuar nga "Shkolla e Lartë Universitare Jopublike Universiteti European i Tiranës" në Universiteti European i Tiranës.

1.2 Ky statut përcakton hollësishët: organizimin, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

##### **Neni 2**

2.1 UET është në pronësi të shoqërisë tregtare "EEI" SHPK, e cila ka fituar personalitet juridik me Vendimin Nr. 36117, datë 07.07.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor-Tiranë.





2.2 Shoqëria tregtare "EEI" SHPK, siguron që çdo vendim i strukturave akademike lidhur me politikat e drejtimit dhe të organizimit të studimeve në institucion, të jetë në respektim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.3 Shoqëria "EEI" SHPK merr në konsideratë dhe vlerëson të gjitha propozimet që vijnë nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike dhe administrative të UET. Ajo vendsos për çështje të politikave të zhvillimit dhe të zgjerimit të UET.

#### Neni 3

##### Vendndodhja

3.1 UET ushtron aktivitetin e tij, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H. 1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

#### Neni 4

##### Përkufizimet e termave

Në kuptim dhe interpretim të këtij Statuti, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

###### 4.1 Studenti/tja

Do të thotë ai person që ka lidhur kontratën e regjistrimit me UET dhe është pajisur me numër të veçantë matrikullimi nga QSHA.

###### 4.2 Viti Akademik

Do të thotë periudha kohore e zhvillimit të procesit mësimor, e organizuar në semestra, i cili përcaktohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin.

###### 4.3 Tarifat

Do të thotë pagesa e shkollimit si dhe pagesa të tjera shtesë sipas parashikimeve të Kontratës si dhe Anekset përkatëse lidhur ndërmjet Studentit dhe UET dhe në aktet rregullatore të UET.

###### 4.4 Regjistrimi

Do të thotë nënshkrimi i kontratës për ndjekjen e studimeve nga studenti me UET, pagesën e tarifës, reflektimi në regjistrin e amzës së UET dhe pajisja me numrin e veçantë të matrikullimit nga QSHA.

###### 4.5 Aktet rregullatore

Janë dokumentacioni që rregullon veprimtarinë e UET, të miratuara nga organet përkatëse, në zbatim të legjislacionit dhe statutit.

###### 4.6 Studimet e ciklit të parë

Do të thotë studime në programet "Bachelor", që realizohen me së paku 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer sipas ligjit.

###### 4.7 Studimet e ciklit të dytë

Do të thotë studimet në programet "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional".

"Masteri i Shkencave" realizohet me të paktën 120 kredite, me kohëzgjatje normale dy vite akademike. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.

"Masteri Profesional" realizohet me 60 ose 120 kredite, me kohëzgjatje normale një vit ose dy vite akademike. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "Master Profesional" në fushën e arsimimit të kryer.

###### 4.8 Studimet e ciklit të tretë

Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës.





Programet e studimeve "Master ekzekutiv" realizohen me kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer.

Studimet e doktoratës kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese dhe zgjasin jo më pak se tre vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".

## Neni 5

### Veprimtaria

- 5.1 UET është një institucion jo publik i arsimit të lartë që kryen veprimtari mësimore e kërkimore, ai ndërthur, në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore, mësimdhënien me kërkimin shkencor, të organizuar ose të pavarur.
- 5.2 UET e kryen këtë veprimtari në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
- 5.3 UET, në kuadër të veprimtarive të Shoqërisë "EEI" SHPK kryen edhe aktivitet të pavarur ekonomik, që rregullohet nga legjislacioni tregtar në fuqi.

## Neni 6

### Qëllimi dhe objektivat

#### Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike

- 6.1 Vizioni: Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselencë në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike, juridike, të edukimit e të teknologjisë së informacionit në vend, me ndikim në rajon e më gjerë, si dhe një qendër ekselencë përkërkimin shkencor në drejtimet specifike ku zotëron potencial.
- 6.2 Misioni: T'u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.
- 6.3 Për realizimin e Vizonit dhe Misionit të tij, UET ka si Objektiva Strategjike:
  - a. Arritjen e ekselencës në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit;
  - b. Mbajtjen e një profesorati të shquar që zotëron vlerat dhe aftësitë më të larta profesionale;
  - c. Cilësinë e lartë në proceset akademike dhe të infrastrukturës së institucionit;
  - d. Pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin dijet, aftësitë dhe eksperiencën e tyre te vlefshme;
  - e. Ndërtimin e urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
  - f. Krijimin e një mqedisi nxitës e zhvillues për profesoratin, punonjësit dhe studentët;
  - g. Sigurimin e një mqedisi të qëndrueshëm për ndjekjen e ekselencës;
  - h. Sigurimin e fleksibilitetit dhe përgjegjshmërisë.

## Neni 7

### Parimet bazë

- 7.1 UET është institucion jopublik i arsimit të lartë, laik dhe me karakter jopolitik.
- 7.2 UET gjëzon liri akademike në procesin mësimor, në kërkimin shkencor dhe në lirinë e krijimit



në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

- 7.3 UET gjëzon autonomi akademike, që shprehet në respektimin e shumëlojshmërisë së opinioneve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënieς e të kërkimit shkencor, në përputhje me planet dhe me programet mësimore të hartuara e të miratuar nga strukturat përkatëse të UET, për të gjitha nivelet dhe programet e studimit.

### Neni 8

#### Të drejtat e UET

Në zbatim të autonomisë institucionale dhe lirisë akademike UET ka të drejtë:

- 8.1 Të zgjedhë lirisht programet e studimet që do të ofrojë në institucion përkundrejt plotësimit të standardeve akademike respektive; të miratojë plane, programe mësimore dhe të kërkimit shkencor, tekste në përdorim të studentëve të tij, si dhe literaturën përkatëse; të përcaktojë, nëse e vlerëson të arsyeshme, kriterë të veçanta për çdo program studimi, si kusht për pranimin e studentëve në to, për çdo vit akademik; të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënien e bursave të studimit.
- 8.2 Të zgjedhë lirisht strukturën institucionale të UET, autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas këtij Statuti deri në nivel departamenti/grup lëndësh; të përzgjedhë personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe personelin administrativ, gjithmonë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
- 8.3 Të përcaktojë fushat e kërkimit shkencor dhe të zhvillojë programin e tij me orientim të gjerë evropian dhe ndërkombëtar;
- 8.4 Të krijojë lidhje bashkëpunimi me struktura universitare (të ngjashme ose të përaferta) të arsimit të lartë ose të kërkimit shkencor brenda ose jashtë vendit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë; të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë publik ose jo publik;
- 8.5 Të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me zbatimin praktik të mësimdhënieς dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut;
- 8.6 Të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e Arsimit të Lartë;
- 8.7 Të përdorë tokën, ndërtesat dhe pasuritë e tjera që zotëron ose që ka në qiramarrje për qëllime të arsimimit, ose që lidhen me të;
- 8.8 Të zotërojë çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 9

#### Paprekshmëria

- 9.1 Të gjitha mjediset e UET gjëzojnë paprekshmërinë që Ligji 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", u garanton institucioneve të arsimit të lartë.
- 9.2 Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike të UET bëhet vetëm në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në rastet e nevojës ekstreme dhe me kërkesën dhe/ose lejen e Rektorit ose të personave të autorizuar nga ai.
- 9.3 Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e Rektorit.





## Neni 10

### Detyrimet e UET

UET detyrohet:

- 10.1 Të zhvillojë procesin mësimor si dhe atë kërkimor e shkencor sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe në përputhje me normat dhe standardet bashkëkohore të vendeve që bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD);
- 10.2 Të respektojë angazhimet e ndërmarra prej tij që burojnë nga kontratat me studentët dhe pedagogët;
- 10.3 Të raportojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për veprimtarinë e tij mësimore-shkencore sipas parashikimeve ligjore;
- 10.4 T'u nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit dhe atij institucional;
- 10.5 Të bëjë publike programet e studimit që ofron sipas niveleve;
- 10.6 Të bëjë të njohur publikisht raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, si dhe nëse programet e studimit që ai ofron janë të akredituara në respektim të afateve kohore të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë;
- 10.7 Të paraqesë çdo fillim viti akademik gjendjen financiare të institucionit, përbërjen e stafit akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin në vazhdim, për secilin program studimi, konform legjislacionit ne fuqi;

## Neni 11

### Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë

- 11.1 UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
- 11.2 Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
- 11.3 Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësítë e UET, me synim përmirësimin e vazdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.
- 11.4 Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UET i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 12

### Përfaqësimi juridik

- 12.1 UET përfaqësohet sipas rastit nga Administratori dhe/ose Rektori. Personi Juridik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit.





## KREU II

### STRUKTURA E UET

#### Neni 13

##### Njësitë përbërëse

- 13.1 UET përbëhet nga njësi: kryesore, bazë, ndihmëse–akademike dhe njësi administrative.
- 13.2 Njësitë kryesore, bazë dhe ato ndihmëse–akademike krijohen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik.
- 13.3 Në UET, në të ardhmen, mund të krijojen edhe njësi të tjera kryesore, bazë ose ndihmëse–akademike, të cilat do të organizohen sipas parimeve të strukturës përkatëse, të shprehura në këtë statut, si dhe akteve ligjore në fuqi.

#### Neni 14

##### Njësitë kryesore

- 14.1 Njësi kryesore janë fakultetet si dhe institutet kërkimore -shkencore
- 14.2 **Fakulteti** është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor në fusha të përaferta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë.
- 14.3 UET përbëhet nga jo më pak se 3 fakultete. Shih Aneksin Nr. 1.

#### Neni 15

##### Njësitë bazë

- 15.1 Njësi bazë janë departamentet dhe qendrat kërkimore - shkencore.
- 15.2 **Departamenti** është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përaferta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
- 15.2.1 Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore- shkencore.
- 15.2.2 Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.
- 15.2.3 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të departamentit si dhe detyra të tjera të tij përcaktohen në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë si dhe rregulloren bazë të institucionit.
- 15.3 **Qendra kërkimore -shkencore** është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvilliimi.
  - 15.3.1. Ajo ka në përbërje të saj të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.
  - 15.3.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të qendrave kërkimore - shkencore si dhe detyra të tjera të tyre përcaktohen në rregulloren e UET.
  - 15.3.3. Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve "Master i shkencave" dhe "Doktoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.
  - 15.3.4. Struktura e qendrës, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.



15.3.5. Kur qendra nuk përbush standarde e njësisë bazë, ajo nuk llogaritet për qëllimin e përbushjes së standardeve institucionale, si njësi bazë e njësisë kryesore.

Neni 16

## Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

- 16.1 Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një strukturë autonome, e përherershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimitarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit ne fuqi.
  - 16.2 Ai përbëhet nga Kryetari i Komisionit, 1–2 përfaqësues nga çdo fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës–akademik ose ai administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve dhe 1 anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm.
  - 16.3 Komisioni ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ai realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ai organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies përlindët e çdo programi studimi.
  - 16.4 Organizimi dhe funksionimi më i detajuar i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe i Sistemit të Vlerësimit të Brendshëm të UET përcaktohen në Rregulloren e UET.

Neni 17

## 17.1 Njësitë ndihmëse mësimore

Njësi ndihmëse konsiderohen laboratorët, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit akademik dhe të kërkimit shkencor.

0

## 17.2 Njësitë administrative

Njësi administrative sipas Aneks 2 të Statutit.

Neni 18

## Organe këshilluese

### **18.1 Organet këshilluese të UET janë:**


- a. Bordi i Besimit
  - b. Presidenti i Bordit të Besimit
  - c. Bordet e Tregut të Punës

18.2. Bordi i Besimit është një organ konsultativ i përbërë nga 5 deri në 9 personalitetë të fushave të ndryshme.

18.2.1. Përbërja dhe numri i anëtarëve të Bordit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të "EEI" SH.P.K, në konsultim me Rektorin.

18.2.2. Funksionet kryesore të Bordit të Besimit janë:

  - a. emëron Presidentin, me propozim të Asamblesë së Ortakëve;
  - b. konsulton mbi zgjedhjet dhe politikat e UET;
  - c. konsulton mbi projektet e zhvillimit;





- d. lobon për imazhin e UET dhe lidhjet e UET me tregun e punës;
- e. lobon për sa i përket politikave të Arsimit të Lartë në Shqipëri;
- f. propozon kandidaturat për Rektor;

#### 18.3. Presidenti

- 18.3.1. Bordi i Besimit propozon një nga anëtarët e tij për kryetar bordi, i cili emërohet nga Administratori. Kryetari i Bordit është njëkohësisht edhe President i UET. Ai drejton Bordin e Besimit të UET dhe ndjek realizimin e detyrate të përcaktuara nga Bordi gjatë dy mbledhjeve të tij. Presidenti ka mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Presidenti mban titullin akademik "Profesor".
- 18.3.2. Presidenti në emër të Bordit të Besimit, ushtron këto kompetenca:
  - a. koordinon aktivitetin e Bordit të Besimit;
  - b. ndjek zbatimin e vendimeve të Bordit dhe raporton para tij për realizimin e tyre;
  - c. drejton lobimin në funksion të përbushjes së misionit të UET;
  - d. drejton promocionin dhe marrëdhëniet me publikun, përfshirë marrëdhëniet me median, pushtetin qendror dhe atë lokal; me përfaqësítë diplomatike si dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj;
  - e. drejton dhe koordinon hartimin dhe zbatimin e planit strategjik të zhvillimit të UET;
  - f. drejton dhe koordinon veprimtaritë në kuadër të partneriteteve strategjike të UET;
- 18.4. Bordet e Tregut të Punës ngrihen në nivel Departamenti dhe përbëhen nga 5–7 anëtarë, të cilët janë drejtues, administratorë të sipërmarrjeve private ose institucioneve publike, ish-studentë të UET.
  - 18.4.1. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Bordet konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkosat e tregut të punës.
  - 18.4.2. Në fund të çdo viti akademik, Bordet angazhohen për të garantuar mbarëvajtjen e praktikave profesionale, stazheve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës.

### KREU III

#### ORGANIZIMI AKADEMIK

##### Neni 19

##### Organet drejtuese akademike

- 19.1 Organet drejtuese të UET janë:
  - a. Senati Akademik
  - b. Rektorati
  - c. Asambleja e Personelit Akademik
  - d. Dekanati
  - e. Këshilli i Etikës
  - f. Komisioni i Përherershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në nivel fakulteti
  - g. Komisioni i Përherershëm për Promovimin e Personelit Akademik në nivel universiteti
- 19.2 Senati Akademik
  - 19.2.1 Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik i UET dhe kryesohet dë thirret nga Rektori.
  - 19.2.2 Senati Akademik mblidhet periodikisht, së paku 4 herë në vit.
  - 19.2.3 Senati Akademik përbëhet nga jo më pak se 21 anëtarë.



- 19.2.4 Senati akademik kryesohet nga Rektori. Anëtarët e Senatit Akademik, zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të fakulteteve, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik më kohë të plotë, të vetëkandiduar, që plotësojnë kriteret e ligjit. Anëtarë të senatit akademik janë edhe kryetari i Këshillit Studentor dhe dy studentë të tjerë përfaqësues të tre ciklevë të studimit, që zgjidhen nga këshilli studentor, mandati i të cilëve është 2– vjeçar.

19.2.5 Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve dhe merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës.,

19.2.6 Mandati i anëtarëve të senatit mbaron:

  - me mbarimin e afatit 4 vjeçar,
  - me kërkesën e tyre,
  - kur mungon në më shumë se 2 (dy) mbledhje të Senatit,
  - për shkelje të kodit etik të institucionit,
  - në rastet kur ndaj tyre ka filluar dhe mbetet në fuqi një procedim penal,
  - në rastet e largimit nga UET,
  - kur humbet zotësinë juridike për të vepruar,
  - në rast vendimmarrje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për riorganizim të Senati.

19.2.7 Funksionet kryesore të Senatit Akademik në drejtimin akademik–shkencor janë:

  - garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
  - miraton statutin e UET me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
  - miraton rregulloret dhe aktet e tjera, sipas propozimeve të Rektorit;
  - vlerëson dhe miraton programet e studimit, programet e kërkimit dhe të zhvillimit si dhe ndryshimet në këto programe, me propozim të Rektorit dhe/ose njësive kryesore të UET. Senati Akademik e ushtron këtë kompetencë në përputhje me planin disavjeçar të zhvillimit të UET dhe duke marrë në konsideratë interesat financiarë të UET;
  - miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
  - miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjësë për arsimin;
  - jep mendimin e tij në lidhje me projekt–buxhetin e UET, të përgatitur nga administrata e UET, përpara se të paraqitet për miratimin e tij nga Asambleja e Ortakëve
  - garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET;
  - krijon mekanizmat përvlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe atë ndihmës akademik të institucionit, mbi përgatitjen e tyre, si dhe cilësinë akademike e profesionale;
  - organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;
  - përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës;
  - miraton kuotat dhe kriteret e pranimit mbështetur në propozimet e njësive dhe autoritatetve përbërëse të UET të cilat miratohen vetëm me vendim të Bordit të Administrimit;

19.3 Rektorati është një organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:

  - Rektori





- b. Zëvendësrektorët
  - c. Administratori i UET
  - d. Drejtuesit e njësive kryesore
  - e. Sekretari i Përgjithshëm
  - f. Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore
- 19.3.1 Rektorati, përveç misionit, të drejtave dhe detyrave të përcaktuara nga ligji, ka edhe këto kompetenca e funksione:
- a. harton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit;
  - b. harton programin vjetor të veprimitarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik;
  - c. ushtron kontolle tematike ose për aspekte konkrete, të njoftuara paraprakisht ose jo, për përbushjen e detyrave dhe qëllimeve të tyre, si dhe për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit, Rregullores bazë dhe akteve të tjera të organeve dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit;
  - d. monitoron procesin e kualifikimit shkencor të personelit akademik dhe rekomandon masat dhe krijon mundësität e nevojshme për të nxitur e mbështetur këtë proces në vijimësi;
  - e. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
  - f. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik të cilat i drejtohen atij;
  - g. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimitarive të institucionit;
  - h. propozon strukturën e përgjithshme institucionale si dhe kategoritë e personelit akademik që nevojiten sipas niveleve të studimit;
  - i. shqyrt俊 trajtimin e rasteve përjashtimore, bazuar në kërkesën me shkrim të një organi ose autoriteti drejtues të UET, ose personi të interesuar. Në çdo rast, vendimi nuk mund të anashkalojë detyrimin për shlyerjen e detyrimeve që garantojnë përbushjen e standardeve akademike;
  - j. harton raportin vjetor të veprimitarive mësimore e kurrikulare dhe e paraqet atë për miratim në Senat;
  - k. lëshon urdhra dhe udhëzime për të gjitha strukturat përbërëse të UET;
- 19.3.2 Rektorati si organ kolegjal funksionon me mbledhje. Vendimet merren në mbledhje të organizuara rregullisht me tematikë të përcaktuar e të njoftuar të paktën dy ditë para mbledhjes. Në raste urgjente, tematika komunikohet në fillim të mbledhjes.
- 19.3.3 Mbledhja e Rektoratit kryesohet dhe thirret nga Rektori dhe është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
- 19.3.4 Sipas tematikës, në mbledhje mund të marrin pjesë edhe Përgjegjësit e Departamenteve dhe drejtues të njësive të tjera administrative të UET.
- 19.3.5 Organizimi dhe veprimitaria e Rektoratit përcaktohet me rregullore të veçantë.
- 19.4 Asambleja e personelit akademik
- 19.4.1 Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
- 19.4.2 Asambleja e personelit akademik në UET këto funksione:
- a. zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;
  - b. krijon dhe zgjedh anëtarët e komisionit të përhershëm të njësisë kryesore;
- 19.5 Dekanati është organ kolegjal vendimmarrës, që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:



nga:

- a. Dekani
  - b. Zëvëndësdekani
  - c. Administratori i Fakultetit
  - d. Përgjegjësit e Departamenteve
  - e. Përgjegjësi i Qendrës së Kërkimore - shkencore
  - f. Kryetarët e Komiteteve Shkencore të Programeve Master
  - g. Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit si përfaqësues i studentëve.

19.5.1 Dekanati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve. Ai merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës.

19.5.2 Dekanati kryen funksionet e mëposhtme:

  - a. harton planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të administratorit të njësisë kryesore;
  - b. koordinon veprimtarinë e njësive bazë;
  - c. programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit;
  - d. bën propozime në Senat për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, ose edhe për ndryshime në programet ekzistuese të studimit, mbështetur në propozimet e ardhura nga departamentet ose edhe me iniciativën e tij;
  - e. i propozon Senatit për dhënien e mendimit paraprak në lidhje me hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera;
  - f. përgatit rregulloren mësimore për çdo program studimi të njësisë së tij, dhe ia dërgon për miratim Senatit Akademik;
  - g. i propozon Senatit kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit;
  - h. jep mendim për rregulloren e institucionit, për çështje brenda fushave të tij të kompetencës;
  - i. jep mendim për rregullore ose akte të tjera të institucionit, mbështetur në kërkesën e Rektorit;
  - j. shqyrton dhe miraton raportin vjetor të Dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor;
  - k. i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij;
  - l. shqyrton dhe miraton temat e diplomave të studentëve që ndjekin studimet në Programet e Studimit të nivelit të parë dhe të dytë;

19.6 **Këshilli i Etikës** është organ kolegjal vendimmarrës, i cili ngrihet pranë UET si një strukturë e përhershme.

19.6.1 Ai promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës shqyrton sjellje të ndryshme të personelit akademik dhe atij ndihmës të institucionit nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo. Këshilli shqyrton gjithashtu edhe sjellje të studentëve gjatë veprimtarisë së tyre mësimore e kërkuese në institucion, nëse ato përbëjnë shkelje të etikës së studentit. Këshilli i Etikës mblidhet sa herë ka çështje për të diskutuar brenda juridikzionit ë tij. Ai merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozime Rektorit për këto çështje.

19.6.2 Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë dhe kryesohet nga një prej zëvëndësrektoretve





ndërsa 4 anëtarët e tjerë, një ndër të cilët i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve, përzgjidhen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.

- 19.6.3 Në lidhje më çështjet e etikës dhe të integritetit akademik në UET, çfarë nuk parashikohet në këtë Statut dhe në Rregulloren e UET, rregullohet nga Kodi i Etikës dhe Kodi i Integritetit Akademik të UET, të cilat janë akte të veçanta të cilat i bashkëlidhen rregullores së institucionit dhe miratohen nga Senati Akademik.

### **19.7 Komisionet e përhershme**

- 19.7.1 Komisionet e përhershme janë organe kolegiale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
- 19.7.2 Komisionet e përhershme krijohen në nivel universiteti dhe fakulteti. Ato përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh.
- 19.7.3 Mënyra e zgjedhjes, procedura, funksionet dhe organizimi i këtyre komisioneve përcaktohen në rregulloren e UET në përputhje me legjisacion shqiptar për arsimin e lartë në Shqipëri.
- 19.7.4 Komisionet e përhershme në UET janë:
- Komision i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në nivel universiteti. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata mbajnë titullin "Profesor".
  - Komision i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në nivel fakulteti. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".
  - Komision i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime përmirësimë të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjisacionit ne fuqi. Ai përbëhet nga Kryetari i Komisionit, 1-2 përfaqësues nga çdo fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose ai administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve dhe 1 anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm.
  - Komisioni për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Institucionit. Ky komision krijohet në nivel institucioni dhe kujdeset përmirësimi i mbarëvajtjen e performancës akademike të tij nëpërmjet shqyrtimit të literaturës akademike dhe shkencore që rekomandohet në programet e studimit dhe pasurimit të vazdureshëm të Bibliotekës së universitetit, përmirësimi të veprimtarisë kërkimore – shkencore në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë dhe përmirësimi i mbarëvajtjen e partneritetit të UET me të tretë, brenda dhe jashtë vendit.
  - Komisioni i Përhershëm i Dhënes së Bursave në UET, krijohet në nivel universiteti dhe kujdeset përmirësimi i mbarëvajtjen e studentëve dhe dhënen e bursave. Funksioni i tij është të shyrtojë dhe miratojë llojin e bursës dhe ndarjen e saj, të vendosë kriteret dhe dokumentacionin përmirësimi i mbarëvajtjen e partneritetit të UET me të tretë, brenda dhe jashtë vendit.


### **Neni 20 Autoritetet drejtuese akademike**

Statuti i Universitetit jo publik Universiteti European i Tiranës, miratuar nga Senati Akademik me Vendim Nr.08, Datë 03/11/2016.





- a) Rektori  
b) Zëvendësrektorët  
c) Dekani  
d) Përgjegjësi i Departamentit  
e) Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore shkencore
- 20.2 Autoritetet drejtuese të UET janë personel akademik i punësuar me kohë të plotë. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve drejtuese rregullohen me kontratë dhe/ose vendim të veçantë. Shkarkimi, lirimi nga detyra apo dorëheqja e Autoritetit drejtues nuk cenon kontratën bazë të punës midis UET dhe individit, në cilësinë e tij si personel akademik.
- 20.3 **Rektori**  
Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UET, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
- 20.3.1. Rektori mban titullin "Profesor".
- 20.3.2. Rektori propozohet nga Bordi i Besimit dhe emërohet nga Administratori. Marrëdhëniet e tij me institucionin përcaktohen në kontratën e punës. Rektori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
- 20.3.3. Mandati i Rektorit mbaron kur ai largohet, për çështje personale dhe/ose shëndetësore, kur prishet kontrata e punës, kur i përfundon kontrata e punës, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmon ton integritetin e institucionit. Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi te formës se prerë nga organet përkatëse. Ministri përgjegjës për arsimin komandon në detyrë një prej zëvendësrektorëve për një afat deri në gjashtë muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në institucion.
- 20.3.4. Rektori ka këto kompetenca kryesore:
- drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij;
  - nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në UET.
  - I paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit të UET.
  - drejton tërë procesin akademik dhe shkencor të UET;
  - ndjek dhe siguron zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, të vendimeve të Rektoratit dhe vendimet që burojnë nga zbatimi i akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me disiplinimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të UET, si edhe nxjerr akte të nevojshme në zbatim të tyre;
  - miraton planet strategjike të zhvillimit të fakulteteve;
  - i paraqet Senatit Akademik projektbuxhetin e institucionit për të dhënë mendim para paraqitjes së tij për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të "EEI" SHPK", si dhe planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimitarive të tij;
  - i paraqet Senatit Akademik statutin e institucionit si edhe ndryshimet që mund t'i bëhen atij si dhe rregulloret e institucionit që janë kompetencë e këtij të fundit;
  - monitoron dhe garanton lirinë akademike e kërkimore të personelit akademik të UET;
  - organizon ose ushtron kontolle në fakultete e departamente për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit të personelit akademik;
  - administron kërkimin shkencor, përfshirë grantet, donacionet dhe çdo fond tjeter në mbështetje të këtij kërkimi;
  - mbikëqyr ngritjen e fondevë nga individë dhe fondacione për zhvillim, dhe kërkimin shkencor;





- m. ngrë komisione e grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta;
  - n. drejton procesin e hartimit dhe miratimin e rregullores dhe të akteve rregulatorë të UET;
  - o. organizon procesin e përzgjedhjes së kandidaturave të personelit akademik të UET, tërheq mendimin e dekanit të fakultetit përkatës dhe emëron personelin akademik dhe ndihmës akademik të brendshëm dhe të jashtëm për secilin nga fakultetet e UET;
  - p. emëron dhe shkarkon zëvendësrektorët, dekanët e fakulteteve, zëvendësdekanët e fakulteteve, përgjegjësit e departamenteve, përgjegjësit e Qendrave Kërkimore Shkencore;
  - q. zgjidh çështjet e kompetencës mes organeve dhe drejtuesve të njësive të UET;
  - r. emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore;
  - s. vendos për rastet përjashtimore;
  - t. nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin; si dhe certifikata të tjera të UET;
  - u. mbikëqyr jetën dhe aktivitetet studentore si grupet kulturore, qëndrat studentore si dhe Zyrën e Pranimit dhe Kujdesit ndaj Studentit;
  - v. përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve, në përputhje me këtë statut dhe rregulloren e UET;
  - w. në rast mungese delegon një nga Zëvendësrektorët për ta përfaqësuar.
- 20.4 Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
- 20.4.1 Dekani është personel akademik i kategorisë "Profesor".
- a. Dekani përzgjidhet mbi bazën e një procedure konkurrimi, për kandidatë brenda dhe jashtë UET. Propozimi për Dekan i përcillet për miratim Rektorit, nga një komision i posaçëm. Procedura e aplikimit, konkurrimit dhe përzgjedhjes përcaktohen më specifiksht në Rregulloren e UET.
  - b. Dekani emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij me shoqerinë përcaktohen në kontraten e punës
  - c. Dekani emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë
  - d. Mandati i Dekanit mbaron kur ai largohet, për çështje personale dhe/ose shëndetësore, kur prishet kontrata e punës, kur i përfundon kontrata e punës, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton integritetin e institucionit. Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marjen e një vendimi te formës se prerë nga organet përkatëse. Deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, Rektori vundos zëvendësimin e tij nga Zëvendësdekani ose një person tjetër me kualifikime të ngjashme.
  - e. Dekani i Fakultetit është anëtar i Rektoratit.
- 20.4.2 Dekani i Fakultetit, ka këto kompetenca:
- f. organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe shkencor të Fakultetit;
  - g. për çdo vendimmarje të Dekanatit përgatit propozimin përkatës;
  - h. ushtron kontolle për cilësinë e zhvillimit të proceseve akademike me karakter mësimor e të kërkimit shkencor, zbatimit të kontratës së punës dhe detyrimeve të tjera të marra nga departamenti apo personeli akademik i fakultetit;
  - i. paraqet raportin vjetor ose raportimet me kërkesë të organeve të fakultetit apo edhe me iniciativë të tij përpara Dekanatit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në Fakultet;



- j. paraqet në Dekanat me iniciativën e tij ose të njësive bazë të fakultetit propozimet për hapjen, mbylljen, reformimin e kurrikulave të departamenteve apo njësive të veçanta të tij;
- k. ngre dhe miraton komisionet për përgjedhjen e studentëve të rinj që pranohen çdo vit akademik;
- l. është pjesë e komisionit për vlerësimin e kandidaturave të stafit akademik të UET për Fakultetin që drejtont;
- m. bën propozimin për punësimin si pjesë e stafit akademik të kandidaturës së përgjedhur, e cila është kusht për lidhjen e Kontratës së Punës mes personelit akademik dhe UET;
- n. bën vlerësimin e performancës akademike të pedagogëve gjatë vitit akademik;
- o. kur e sheh të arsyeshme, bën vlerësimin e personelit akademik gjatë vitit akademik;
- p. ngre komisionet *ad-hoc* sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloret e UET;
- q. trajton rastet e shkeljeve të disiplinës, duke iu propozuar organeve kompetente masat përkatëse, sipas përcaktimeve në Statut, Kodin e Etikës dhe Rregulloren e UET;
- r. së bashku me Rektorin nënshkruan diplomat e studentëve të UET;
- s. propozon masa disiplinore në Këshillin e Etikës për studentët, anëtarët e personelit akademik dhe atij ndihmës që kanë kryer vepime në kundërshtim me statutin dhe Rregulloren e UET, kanë thyer Kodin e Etikës, Rregullave të Etikës apo nuk kanë respektuar detyrimet e përcaktuara në Kontratën e studentit, Kodin e Punës ose në kontratën e punës;
- t. Nënshkruan diplomat e studentëve;
- u. i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore;

20.5 **Përgjegjësi i Departamentit** është autoriteti drejtues akademik i Departamentit dhe e përfaqëson atë.

20.5.1. Përgjegjësi i Departamentit është person akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" (PhD).

Përgjegjësi i Departamentit në UET përzgjidhet mbi bazën e një procedure konkurrimi, për kandidatë brenda dhe jashtë UET. Propozimi për Përgjegjësin Departamenti i përcillet për miratim Rektorit, nga komision i posaçëm, i cili kryesohet nga Dekani i fakultetit përkatës. Procedura e aplikimit, konkurrimit dhe përgjedhjes përcaktohen më specifiksht në Rregulloren e UET.

20.5.2 Përgjegjësi i Departamentit emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij me shoqërinë përcaktohen në kontratën e punës.

20.5.3 Përgjegjësi i Departamentit emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

20.5.4 Mandati i Përgjegjësit të Departamentit mbaron kur ai largohet, për çështje personale dhe/ose shëndetësore, kur prishet kontrata e punës, kur i përfundon kontrata e punës, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmon ton integritetin e institucionit. Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi te formës se prerë nga organet përkatëse. Deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, Rektori vendos zëvendësimin e tij nga Zëvendësdekani ose një person tjetër me kualifikime të ngjashme.

20.5.5 Përgjegjësi i Departamentit ka këto kompetenca:

- organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të Departamentit;
- shqyrton planet mësimore dhe programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme;





- c. shqyrtan dhe miraton propozimet e përgjegjësit të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren;
- d. ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies;
- e. merr pjesë në komisionet e përzgjedhjes së pedagogëve të rinj për departamentin që drejton;
- f. bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit akademik dhe për këtë qëllim ndjek zhvillimin e një orë leksioni/seminari në auditor, me njoftim paraprak së paku 2 (dy) javë përpara;
- g. emëron dhe shkarkon përgjegjësin e grup lëndëve;
- 20.6 **Përgjegjësi i grup-lëndëve** është përgjegjës për konsultimin e lëndëve të përbashkëta brenda një departamenti, për të garantuar cilësinë e programeve të lëndëve, brenda ekspertizës së tij, në përputhje me kriteret, standarde dhe procedurat e UET, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë metodologjik. Shqyrtan dhe miraton programet e grup lëndëve përkatëse, detyrat e kursit dhe tezat e provimeve të tyre.
- Përgjegjësi i grup-lëndëve propozohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe emërohet nga Rektori për një mandat maksimalisht 4 vjeçar.
- 20.7 **Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore** është autoriteti drejtues akademik i Qendrës Kërkimore Shkencore dhe e përfaqëson atë. Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore është person akademik i kategorisë "Profesor" ose "Doktor i Shkencave" (PhD).
- 20.7.1. Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore në UET përzgjidhet mbi bazën e një procedure konkurrimi, për kandidatë brenda dhe jashtë UET. Propozimi për Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore i përcillet për miratim Rektorit, nga komision i posaçëm. Procedura e aplikimit, konkurrimit dhe përzgjedhjes përcaktohen më specifiksht në Rregulloren e UET.
- 20.7.2. Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij me shoqërinë përcaktohen në kontratën e punës.
- 20.7.3 Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
- 20.7.4 Mandati i Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore mbaron kur ai largohet, për çështje personale dhe/ose shëndetësore, kur prishet kontrata e punës, kur i përfundon kontrata e punës, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton integritetin e institucionit. Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi te formës se prerë nga organet përkatëse. Deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, Rektori vendos zëvendësimin e tij nga Zëvendësdekani ose një person tjeter me kualifikime të ngashme.
- 20.7.5 Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore ka këto kompetenca:
- përcakton programin dhe tematikën e punës shkencore në Qendër;
  - udhëheq dhe kontrollon realizimin e programit në lidhje me studimet dhe trajnimet sipas tematikës përkatëse;
  - bën vlerësimin e punës shkencore të anëtarëve të Qendrës gjatë vitit akademik;
  - bashkëpunon ngushtë me departamentet e tjera të Fakultetit përkatës dhe strukturat e tjera të UET.



Neni 21

## Autoritete të tjera

- ### **21.1. Autoritete të tjera të UET janë:**

- a. Sekretari i Përgjithshëm
  - b. Zëvendësrektori
  - c. Zëvendësdekani

## **21.2. Sekretari i Përgjithshëm**

- 21.2.1. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Rektori.

- #### **21.2.2. Sekretari i Përgjithshëm ka këto kompetenca:**

- a. drejton dhe koordinon punën e Sekretarisë Mësimore dhe të koordinatoreve të fakulteteve për zhvillimin e veprimtarive mësimore;
  - b. në koordinim me dekanatin përgatit kalendarin akademik të mësimdhënies në UET dhe garanton zbatimin e tij në bashkëpunim me fakultetet përkatëse;
  - c. përgjigjet për cilësinë dhe saktësinë e dokumentacionit për të dhënat nga zhvillimi i procesit mësimor, studentët, të dhënat statistikore që mblidhen, përpunohen, raportohen pranë MAS-it ose përdoren për lëshimin e diplomave, certifikatave dhe dokumenteve të tjera të lidhur me mësimdhënien në UET;
  - d. ndjek përbushjen e detyrimeve kontraktuale të personelit akademik të UET për sa i përket ngarkesës së tyre mësimore dhe informon Zyrën e Burimeve Njerëzore;
  - e. koordinon procesin e transferimit, të mobilitetit, të ndërprerjes dhe të rifillimit të studimeve në UET sipas parashikimeve të Rregullores së UET;
  - f. përgatit paraprakisht listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e hyrjes në provim dhe pas miratimit nga Dekani, i vihet në dispozicion pedagogut para hyrjes në provim;
  - g. zbaton çdo detyrë tjeter që mund t'i ngarkohet nga Rektori dhe raporton tek ai për realizimin e saj;

### **21.3. Zəvəndəsrektori**

- 21.3.1. Zëvendësrektori emërohet dhe shkarkohet nga Rektori. Ai ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë riemërimi.

- 21.3.2. Zëvendësrektori është person akademik i kategorisë "Profesor".

- 21.3.2. Zëvendësrektori është person i ndarëm i Rektorit. 21.3.3. Zëvendësrektori përfaqëson Rektorin në fushën e veprimtarisë akademike që mbulon dhe kryen të gjitha detyrat e tjera që i delegohen/ngarkohen nga Rektori, për të cilat raporton para tij.

- 21.3.4. Numri i zëvendësrektorëve dhe fusha e veprimitarive që mbulojnë përcaktohen me vendim të Rektorit.

## 21.4. Zëvendësdekani

- 21.4.1. Emërohet dhe shkarkohet nga Rektori me propozim të Dekanit të Fakultetit përkatës. Ndihmon Dekanin në drejtimin e fakultetit dhe përgjigjet përpara tij dhe Rektoratit për detyrat e ngarkuara.

- 21.4.2. Zëvendësdekani duhet të jetë i kategorisë profesor.

Neni 22

## **ORGANIZIMI ADMINISTRATIV**

Bordi i Administrimit

- 22.1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të UET, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Ai përbëhet



nga 3 anëtarë, zgjedhja dhe mbarimi i mandatit të të cilëve përcaktohet me rregullore të veçantë.

- 22.2. Anëtarët e Bordit të Administrimit emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e UET sh.p.k.

### Neni 23

#### Funksionimi i Bordit Administrativ

- 23.1. Bordi i Administrimit mblidhet të paktën një herë në vit, si dhe sa herë që do të jetë e nevojshme për të ushtruar kompetencat e veta ligjore dhe statusore. Bordi i Administrimit mblidhet me kërkesë të secilit nga anëtarët e vet si dhe me kërkesë të Administratorit të Institucionit.
- 23.2. Mbledhja e Bordit Administrativ konsiderohet e vlefshme nëse në të marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve.
- 23.3. Vendimet e Bordit Administrativ miratohen me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit të Administrimit.
- 23.4. Procedurat e posaçme për organizimin dhe funksionimin e bordit përcaktohen në akte rregulatorë të UET.

### Neni 24

#### Funkcionet e Bordit të Administrimit

- 24.1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:
- garanton qëndrueshmërinë financiare të UET dhe përbushjen e misionit të tij, duke monitoruar zbatimin e planit finanziar;
  - jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
  - përcakton rregullat dhe destinacionin për shpëmdarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimitarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
  - është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet rregulatorë të UET;
  - është përgjegjës për përzgjedjen dhe financimin e projekteve kërkimore-shkencore. Kriteret dhe mënyra e financimit përcaktohet me rregullore të veçantë.
  - Bordi i Administrimit emëron dhe shkarkon Administratorin e Institucionit me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të EEI SH.P.K.
  - miraton paraprakisht statutin e UET, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
  - miraton raportin e detajuar vjetor të veprimitarisë së UET, të hartuar nga rektorati.
  - miraton planin strategjik të zhvillimit të UET, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik;
  - harton strukturën e përgjithshme të UET dhe përcakton numrin e personelit akademik dhe ndihmës akademik;
  - propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjeter të arsimit të lartë;
  - vendos mbi hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive përbërëse të UET, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr mendimin e Senatit Akademik;





## Neni 25

### Administratori i UET

- 25.1 Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunkcionimin financiar të UET. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të EEI SH.P.K.
- 25.2 Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.
- 25.3 Ai është përfaqësues ligjor i UET për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregulatorë të UET.

## Neni 26

### Funkzionet e Administratorit të Institucionit

- 26.1 Administratori kryen këto funksione:
  - a. harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
  - b. propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
  - c. ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të UET në strukturat e varësisë së tij;
  - d. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
  - e. i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të UET, në përfundim të vitit akademik;
  - f. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të UET për çështje të administrimit të përditshëm;
  - g. emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore pas miratimit të Bordit të Administrimit;
  - h. plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

## Neni 27

### Administratori i njësisë kryesore

- 27.1 Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunkcionimin financiar dhe administrativ të saj. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Administratori i Institucionit pas miratimit nga Bordi i Administrimit. Kriteret dhe procedura e përgjedhjes përcaktohen me vendim të veçantë të Administratorit, në përputhje me ligjin.
- 27.2 Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.
- 27.3 Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.

## Neni 28

### Funkzionet e administratorit të njësisë kryesore

- 28.1. Funksionet e administratorit të njësisë kryesore janë:





- a. realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;
  - b. mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;
  - c. plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
  - d. bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administritmit të saj.
- 29.1 Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës edhe për ushtrimin e funksioneve për njësinë bazë.

#### KREU IV

#### STUDIMET UNIVERSITARE

##### Neni 29

###### Format e studimit

- 29.1 Forma e studimeve në UET është si rregull me kohë të plotë, të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas standardeve të zonës europiane të studimeve.
- 29.2 Programet e studimit në UET normalisht ofrohen në gjuhën shqipe. Programet e studimit mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European, në programe të studimit, të miratuar në aktin përkatës të hapjes.
- 29.3 UET mund të ofrojë edhe programe studimi me kohë të zgjatur, konform legjisacionit në fuqi.

##### Neni 30

###### Programet e studimit

- 30.1 UET, mbi bazën e licencimit dhe akreditimit të akorduar, ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve universitare.
- 30.2 Programi i studimit mund të propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të, anëtarëve të Departamenteve ose të Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave.
- 30.3 Propozimi për hapjen, rishikimin apo mbylljen e një programi studimi shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit e më pas në Senat, vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlgimin e Rektorit.
- 30.4 Plani mësimor për çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordet e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.
- 30.5 Çdo program studimi rregullohet me rregullore mësimore të veçantë.
- 30.6 UET shpall publikisht, kuotat dhe kriteret e pranimit, programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

##### Neni 31

###### Programet e ciklit të parë të studimeve

- 31.1 Programet e ciklit të parë të studimit organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.





- 31.2 Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, përcaktohet në rregulloren e UET.
- 31.3 Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.
- 31.4 Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kritere shtesë të vendosura nga UET.
- 31.5 Pranimi në programet e integrarë të studimeve është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kritere shtesë të vendosura nga UET.

### Neni 32

#### Programet e ciklit të dytë të studimeve

- 32.1 Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit "Master i shkencave" dhe "Master profesional".
- 32.2 Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Ato realizohen në:
  - a. programe me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
  - b. programe të integrarë të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike.
- 32.3 Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.
- 32.4 Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatje normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" në fushën e arsimimit të kryer.
- 32.5 Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të UET.
- 32.6 Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e UET. Kriteret miratohen në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti. Ato bëhen publike.

### Neni 33

#### Programet e ciklit të tretë të studimeve

- 33.1 Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", si dhe studimet e doktoratës.
- 33.2 Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen





përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmballen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer.

- 33.3 Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor përcaktohen me rregullore të veçantë.
- 33.4 Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Masteri shkencave" ose "Master i arteve" dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara në UET në Rregullore të veçantë. Këto kritere bëhen publike nga UET dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### Neni 34

##### Studimet e doktoratës

- 34.1 UET ofron studime të doktoratës me kohë të plotë pranë njësisë bazë, ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- 34.2 Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 35

##### Programet e përbashkëta të studimit

- 35.1 UET është i hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
- 35.2 Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta realizohet në përputhje me legjisacionin në fuqi dhe me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit.
- 35.3 Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.

#### Neni 36

##### Kërkimi Shkencor

- 36.1 UET kryen veprimtari kërkimore shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese të cilat realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga organet kompetente. Fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet e veprimitarës kërkimore-shkencore përcaktohen bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar, në programet e ofruara si dhe në dokumentet strategjikë të kërkimit shkencor në UET.
- 36.2 UET garanton integrimin e veprimitarës kërkimore në atë të mësimdhënies. Veprimitaria kërkimore-shkencore, që kryhet në UET, synon të mbështetë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit.





- 36.3 Veprimtaria kërkimore shkencore në UET si dhe vlerësimi saj rregullohet në përputhje me aktet rregulatorë të UET.

#### Neni 37

##### Transferimet dhe Njohja e periudhave të studimit

- 37.1 UET ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij apo nga dhe në institucione të ndryshme të arsimit të lartë.
- 37.2 Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
- 37.3 Transferimet në UET lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjtë ose të përafërtë dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
- 37.4 Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në Rregulloren e UET dhe Broshurën e Dokumenteve të UET, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 37.5 Vendimi për njohjen e krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në UET, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga departamenti, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 38

##### Viti akademik dhe frekuentimi i procesit mësimor

- 38.1 Studimet në UET zhvillohen në vite akademike. Viti akademik organizohet në semestra.
- 38.2 Frekuentimi i procesit mësimor në UET përcaktohet në rregulloren e institucionit, bazuar në llojin e veprimtarive mësimdhënëse në auditor, ciklit të studimeve dhe akteve nën ligjore përkatëse.

#### Neni 39

##### Programet e përbashkëta të studimit

- 39.1 UET ose njësitë kryesore të tij, realizojnë programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
- 39.2 Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta kryhet në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit.
- 39.3 Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët, e dyfishtë ose e shumëfishtë në varësi të marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- 39.4 Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, UET mund të zbatojë standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
- 39.5 Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet në përputhje me aktet rregulatorë të UET dhe me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### Neni 40

##### Diplomimi

Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare me UET, fiton të drejtën e marjes së diplomës.





- 40.1 Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin hartohen në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë Përgjegjëse për Arsimit. Forma e diplomës, elementet e sigurisë, si dhe elemente të tjera të saj përcaktohen me dokument të veçantë.
- 40.2 Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master ekzekutiv" të ciklit të tretë shoqërohen me suplementin e diplomës.
- 40.3 Përbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në aktet rregulatorë të UET, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë Arsimit dhe Sporteve .
- 40.4 Diploma nuk mund të lëshohet dublikatë. Ajo jepet vetëm një herë. Suplementi i diplomës me kërkesë të personit të interesuar mund të lëshohet dublikatë nga sekretaria mësimore, me shënimin kopje e origjinalit. UET, me kërkesë të personit të interesuar, mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit në përputhje me legjislatacionin ne fuqi.
- 40.5 Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike: nënshkruhet nga kryetari i komisionit të mbrojtjes së diplomave, Dekani i Fakultetit dhe Rektori dhe vuloset me vulën e UET.
- 40.6 Diploma konsiderohet e vlefshme vetëm pas akreditimit të programit përkatës të studimit dhe akreditimit institucional dhe pasi ajo regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

## KREU V

### PERSONELI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

#### Neni 41

##### Personeli i UET

- 41.1 Personeli i UET përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ.
- 41.2 Personeli i UET mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë është me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar dhe përbëhet nga drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe pedagogët "senior". Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, profesorë "Emeritus" dhe personel akademik i ftuar.
- 41.3 Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në këtë statut dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore të aplikueshme. Kontrata e punës lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 8015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Punës, i ndryshuar. Të drejtat dhe detyrimet e personelit, përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe UET.

#### Neni 42

##### Personeli akademik dhe statusi i tij

- 42.1 Personeli akademik gjëzon status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në aktet rregulatorë të UET.





- 42.2 Personeli akademik në UET kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UET, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.
- 42.3 Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
- 42.4 Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në UET përcaktohet nga aktet rregullatorë të UET.
- 42.5 Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 2 , të këtij neni, përcaktohen në aktet rregullatorë të UET.
- 42.6 Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj, përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe UET.
- 42.7 Personeli akademik i punësuar në UET, duhet të zbatojë Kodin e Etikës, Kodin e Integritetit Akademik, këtë statut si dhe aktet e tjera rregullatorë të UET.
- 42.8 Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe si rregull deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik. Kjo e drejtë fitohet përmes një projekti konkret kërkimi ose botimi, të miratuar nga Bordi për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore. Kjo periudhë kohe njihet si vit sabatik, ajo është e paguar dhe anëtari i personelit akademik është i çliruar nga detyra e mësimdhënies.
- 42.9 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjeter të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjeter të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve.

#### Neni 43

##### **Personeli akademik dhe kategoritë**

- 43.1 Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në UET, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
- profesorë;
  - lektorë;
  - asistent-lektorë.
- Nënkategoriizime të tjera brenda kategorive të sipërcituara, rregullohen në aktet rregullatorë të UET.
- 43.2 Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asocuar". Kjo kategori, në rastet e angazhimit me kohë të plotë, punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Personelit akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë përkatëse dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor Emeritus".
- 43.3 Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperience në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbrushin kriteret e përcaktuara në



statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori, në rastet e angazhimit me kohë të plotë, punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

- 43.4 Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave" dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.

#### **Neni 44**

##### **Personeli akademik, punësimi dhe vlerësimi**

- 44.1 Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e saj dhe miratohen nga Rektori. Personeli akademik përzgjidhet me konkurrim pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi, i cili ngrihet me urdhër të Rektorit, në nivel Universiteti, ose Fakulteti. Përbërja e komisionit përcaktohet me urdhër të Rektorit.
- 44.2 Kriteret rregullat dhe procedurat për punësimin e personelit akademik përcaktohen në aktet nënligjore në fuqi dhe aktet rregulatorë të UET. Mosha maksimale e personelit akademik të brendshëm është 65 dhe 68 vjeç ose mosha më e madhe apo më e vogël në varësi të legjislacionit përkatës në fuqi.
- 44.3 Personeli akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike, trajnimeve, testimeve dhe vlerësimeve, të përcaktuara specifikisht në aktet rregulatorë të UET. Për këtë qëllim, Rektori ngre një komision *ad-hoc*, për vlerësimin e performancës.

#### **Neni 45**


##### **Personeli ndihmës akademik**

- 45.1 Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ.
- 45.2 Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor, këshillim për studentët dhe detyra administrative. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit dhe ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme
- 45.3 Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UET në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të UET.
- 45.4 Personeli ndihmës akademik përzgjidhet me konkurrim në përputhje me aktet rregulatorë të UET.
- 45.5 Personeli ndihmës akademik i nënshtrohet vlerësimi periodik të kryer në fund të vitit akademik. Për këtë qëllim, Rektori ngre një komision *ad-hoc*, për vlerësimin e performancës.

#### **Neni 46**

##### **Personeli administrativ**

- 46.1 Personeli administrativ kryen veprimtari administrative në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor në institucion, sipas detyrave të përcaktuara, si dhe shërbimeve për zhvillimin e UET. Ai ndihmon në realizimin e misionit të UET.





- 46.2 Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të UET.
- 46.3 UET përcakton në aktet e veta rregulloratore, procedurat e vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, si edhe procedurat për masat disiplinore.
- 46.4 Personeli administrativ ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshtme.
- 46.5 Personeli administrativ përzgjidhet me konkurrim pas shqyrtimit nga një komision rekrutimi dhe miratohet nga Administratori, i cili nënshkruan kontratat individuale të punës.
- 46.6 Personeli administrativ i nënshtrohet vlerësimit periodik, të kryer në fund të vitit kalendarik nga komisioni përkatës i vlerësimit të performancës, i ngritur me urdhër të Administratorit.

## KREU VI

### SHPËRBLIMET DHE MASAT DISIPLINORE

#### Neni 47

##### Shpërblimet

- 47.1 Shpërblimet jepen për kontribut të dallueshëm në procesin e punës, me propozim të Rektorit dhe miratim të Administratorit të UET.
- 47.2 Parimet e motivimit dhe promovimit të personelit përcaktohen me dokument të veçantë.

#### Neni 48

##### Ekselencia

- 48.1 UET përmes akordimit të çmimeve të ekselencës synon të evidentojë, promovojoë dhe shpërblejë performancën e shkëlqyer.
- 48.2 Çmimet që ofrohen janë:
  - a) Pedagogu më i mirë i vitit në mësimdhënie, që jepet nga Rektori
  - b) Eseja më e mirë e vitit, që jepet nga Rektori;
  - c) Punonjësi më i mirë i vitit, që jepet nga Administratori i UET.

#### Neni 49

##### Masat disiplinore

- 49.1 Masat disiplinore merren anëtarëve të personelit akademik, autoriteteteve drejtuese, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ në rastet e thyerjes së Kodit të Etikës dhe parashikimeve të Kontratës së Punës.
- 49.2 Masa disiplinore u jepen edhe studentëve të regjistruar në UET, të cilët nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë statut, thyejnë Kodin e Etikës dhe parashikimeve të Kontratës së Studentit. Këto masa jepen me vendim të Këshillit të Etikës.
- 49.3 Llojet e masave disiplinore, procedurat për dhënien e tyre, procedurat e ankimit, si dhe shlyerja e tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

## KREU VII

### STUDENTËT





## Neni 50


### **Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

- 50.1 Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UET, dhe është pajisjen me numër të veçantë të matrikullimit. Ky status humbet me marrjen e diplomës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga UET.
- 50.2 Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet rregulatorë të UET dhe kuadrit ligjor në fuqi.
- 50.3 Student ka të drejtë:
- a) të ndjekë të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar;
  - b) të përdorë infrastrukturën, që UET vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai;
  - c) të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së UET, në përputhje me legjislacionin dhe statutin e UET;
  - d) të shprehë vlerësimin e vet për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në UET;
  - e) të nënshkruajë kontratë shërbimi, në momentin e regjistrimit në UET;
  - f) të sigurohen nga UET, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimitarë apo risqe të tjera, sipas përcaktiveve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit të Financave.
  - g) të zgjedhë dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve dhe organet e institucionit, në përputhje me legjislacionin dhe statutin e UET;
  - h) të transferojë kreditet/studimet nga universitete të tjera në UET dhe anasjelltas;
  - i) të jetë të barabartë, por të ndryshëm;
  - j) të organizohet në formën e Klubeve studentore, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre në procesin akademik dhe të kërkimit shkencor;
  - k) të organizohet lirisht në grupime me karakter social, ekonomik, kulturor, sportiv dhe akademik;
  - l) të pajiset me Kartën e Studentit;
- 50.4 Studenti ka për detyrë:
- d) të zbatojë rregullat e përcaktuara nga UET;
  - e) të respektojë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjera;
  - f) të paguajë tarifën e shkollimit dhe tarifa për shërbime të tjera të aplikueshme në UET;
  - g) të respektojë Kodin e Etikës, Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të UET,
  - h) të ndjekë rregullisht seminaret dhe orët e tjera që janë të detyrueshme sipas programit të studimit;
  - i) të marrë pjesë në veprimtaritë akademike;

## Neni 51

### **Këshilli i Studentëve dhe pjesëmarrja në qeverisjen e UET**

- 51.1 Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore, të UET, si edhe në nivel kombëtar.
- 51.2 Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në UET, të cilat nuk zhvillojnë veprimitari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET.





- 51.3 Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Me një rregullore të veçantë përcaktohen procedurat për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve.
- 51.4 Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.
- 51.5 Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes për UET, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
- 51.6 UET mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre.

## Neni 52


### Bursat për studime

- 52.1 UET ofron disa lloje bursash studimi, të plota ose të pjesshme, si:
  - a) Bursa Sociale
  - b) Bursa e Lidershipit
  - c) Bursa e Ekselencës
  - d) Bursa Talenti
  - e) Bursa "Pashko"
- 52.2 Kriteret, procedura e aplikimit dhe e akordimit të bursave dhe kushtet e zbatimit të tyre përcaktohen me rregullore të veçantë.
- 52.3 Bursat akordohen, nga një komision i përhershëm ad-hoc, Komisioni për Akordimin e Bursave, i cili ngrihet nga Administratori/Presidenti i UET.

## Neni 53

### Dokumentacioni i procesit mësimor dhe i të dhënave të studentëve

- 53.1 UET mban në formë të shkruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit:
  - a) regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UET;
  - b) regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UET;
  - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emetimin e tyre nga UET.
- 53.2 Regjistrat shpérndahan nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së UET. Regjistrat plotësohen edhe në formë elektronike.
- 53.3 UET ruan të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Kjo nënkupton që përpunimi i të dhënave personale bëhet në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme.
- 53.4 Parimet bazë ku bazohet përpunimi i të dhënave personale nga UET-i janë ato të sigurisë së informacionit: konfidencialiteti, integriteti, disponueshmëria dhe përditësimi i të dhënave personale.





- 53.5 Të dhënave personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit (UMIS).

## KREU VIII FINANCIMI

### Neni 54

#### Burimet e financimit

- 54.1 UET është institucion jo publik i arsimit të lartë me vetëfinancim. Ai përcakton për çdo fillim viti akademik projektbuxhetin përkatës të institucionit të ndarë në fakultete të cilin e miraton sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut. Burimet financiare të UET ndahen në parësore dhe dytësore.
- 54.2 Burimet parësore të UET janë Financimet nga Shoqëria tregtare "EEI" SHPK, ku përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbime të tjera.
- 54.3 Burimet dytësore të UET janë:
- të ardhura nga shërbime që UET ofron për të tretët;
  - donacione nga sektori publik;
  - donacione nga sektori privat;
  - donacione nga shoqëria civile;
  - donacione nga subjekte ndërkombe;
  - projekte të aplikuara dhe të fituara nga UET;
  - çdo burim tjeter i ligjshëm;
- 54.4 Të gjitha të ardhurat nga burimet dytësore përdoren vetëm në shërbim të institucionit.
- 54.5 Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit.
- 54.6 Kontrolli dhe auditimi i jashtëm kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave, në rastet ku UET akseson fonde publike.

## KREU IX

### DISPOZITA TË FUNDIT


#### Neni 55

#### Të ndryshme

- 55.1 Statuti i UET miratohet dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit dhe i dërgohet për miratim Ministrit të Arsimit dhe Sporteve.
- 55.2 Kur Ministri i Arsimit dhe Sporteve nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar, statuti konsiderohet i miratuar.

#### Neni 56

#### Vula zyrtare dhe stema





- 56.1 UET ka vulen zyrtare, te njomë dhe te thatë, në formë drejtëkëndore ku shkruhet UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, me logon e UET që paraqet një version të stilizuar te Kullës së Sahatit në ngjyrë blu te miratuar me Nr. 659/4 Prot. Datë 21.10.2014 te Drejtorisë së Përgjithshme te Patentave dhe te Markave.

#### **Neni 57**

- 57.1 Në zbatim te këtij Statuti, UET harton rregulloren e institucionit, rregulloret e programeve te studimit, akte te tjera te cituara ne kete statut, ose ne zbatim te legjislacionit per arsimin e larte ne Republiken e Shqipërisë.  
57.2 Cdo akt rregulator i UET duhet te jetë ne përputhje me kete Statut dhe Legjislacionin Shqiptar ne Fuqi dhe depozitohet ne Ministri.

#### **Neni 58**

##### **Anekset**

Anekset janë pjesë përbërëse e këtij Statuti. UET rezervon te drejtën te ndryshojë anekset, duke kerkuar miratimin e ministrisë përgjegjëse per arsimin.

#### **Neni 59**

##### **Dispozita kalimtare**

- 59.1 Ky statut hyn ne fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri përgjegjës per arsimin e larte ne Shqipëri.  
59.2 Me hyrjen ne fuqi te këtij statuti, shfuqizohet statuti ekzistues.  
59.3 Aktet e tjera rregulatorë te UET, mbeten ne fuqi deri ne shfuqizimin e tyre nga senati akademik dhe miratimin e akteve te tjerë rregulatorë, por jo përmes afateve te përcaktuara ne ligjin per arsimin e larte.  
59.4 UET, bazuar ne Nenin 129, Pika 1, te Ligjit per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor dhe ne kete statut, riorganizon strukturën e brendshme akademike dhe administrative, brenda vitit akademik 2016 - 2017. Deri ne konstituimin e strukturave te reja akademike dhe administrative, strukturat ekzistuese ne UET kryejne normalisht funksionet e tyre.  
59.5 Procesi i riorganizimit fillon menjëherë pas miratimit te këtij statuti nga Ministri përgjegjës per arsimin e larte.  
59.6 Procesi i riorganizimit kryhet ne menyrë te përshkallëzuar, duke zbatuar procedurat e krijimit dhe konstituimit te organeve drejtuese dhe autoriteve te tjera te UET.  
59.7 Cdo gjë qe nuk gjen rregullim ne kete statut, do te rregullohet me rregullore te posaçme.





## **ANEKS 1 STRUKTURA AKADEMIKE**

UET përbëhet nga 3 fakultete:

1. Fakulteti Juridik.
2. Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit.
3. Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Fakulteti Juridik përbëhet nga:


- a) Departamenti i të Drejtës Private
- b) Departamenti i të Drejtës Publike
- c) Qendra 'Ligji, Norma, Tradita'

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga:

- a) Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit
- b) Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
- c) Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës.

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit përbëhet nga:

- a) Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
- b) Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
- c) Departamenti i Edukimit






## **ANEKS 2** **STRUKTURA ADMINISTRATIVE**

Struktura kryesore administrative e UET përbëhet nga:

1. Bordi i Administrimit
2. Administratori i UET
3. Administratorët e Njësive Kryesore

Në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të tyre, Administratori i UET dhe Administratorët e Njësive Kryesore asistohen nga Administrata e UET.

Organizimi, përbërja dhe funksionimi i administratës së UET përcaktohet në Rregulloren bazë të institucionit.



33

